

PROJEKTE ME QËLLIME DHE OBJEKTIVA TË QARTA, GARANCI PËR MBARËVAJTJEN E TYRE

*nga Artan TOPJANA – Auditues i Lartë,
botuar në gazetën “Tirana Observer”, më 09 maj 2015.*

Disa nga veprat më të mëdha publike në vendin tonë, financohen nëpërmjet kredive, huave apo granteve. Menaxhimi i projekteve me financime të huaja bëhet nëpërmjet krijimit të njësive të koordinimit, menaxhimit apo zbatimit të projekteve. Në përgjithësi, disbursimi i fondeve, menaxhimi financiar, metodat e prokurimit dhe kushtet e kontratave, bazohen në udhëzuesit e institucioneve financiare kredidhënëse. KLSH, sipas përzgjedhjes auditon aktivitetin e projekteve si në aspektin e zbatimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, ashtu edhe në aspektin vlerësues apo të performancës, i cili ka të bëjë me arritjen e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara.

Në të gjitha projektet, por kryesisht në ato me financime të huaja përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave është thelbësor. Ky hap përcakton rezultatin dhe hapat e nevojshëm për arritjen e rezultateve. Konsulentët apo institucionet që angazhohen për realizimin e projektideve apo përgatitjen e dokumentacionit të projekteve, duhet t’u vlerësojnë siç duhet këtë hap shumë të rëndësishëm. Projektet mund të kenë disa qëllime, por për çdo qëllim duhet të përcaktohen objektiva të caktuara. Qëllime dhe objektiva të përcaktuara dobët, çojnë në shtesë të kostos së projekteve.

Objektiva të sakta janë ato që janë specifike, të matshme, të arritshme, relevante dhe në kohën e duhur.

Sa më të sakta të jenë studimet paraprake, aq më i saktë do të jetë përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave. Përcaktimi i objektivave të projekteve është treguesi kryesor sipas të cilit vërtetohet ajo çfarë do të arrihet dhe a është arritur çfarë është parashikuar. Objektivi identifikohet si “çfarë”, ndërsa qëllimi “si”.

A përcaktohen qartë qëllimet dhe objektivave në projektet me financime të huaja në Shqipëri? Mund të theksohet se në shumicën e tyre ato përcaktohen në mënyrë të përgjithshme dhe të pamatshme. Nëse marrim si shembull projektin e ndërtimit të një segmenti rrugor, sipas të cilit janë vendosur objektivat që pas përfundimit se do të ketë rritje të trafikut dhe zvogëlim të kohës së udhëtimit, vetëm me këtë përcaktim nuk mund të arrijmë në konkluzionin e plotë “çfarë”. Por nëse vendosen objektiva të qarta dhe të detajuara si për shembull, pas ndërtimit të segmentit rrugor trafiku do të rritet 30 %, si dhe koha e udhëtimit do të zvogëlohet me 40 %, atëherë nga krahasimi i të dhënave statistikore për një periudhë të caktuar pas përfundimit të veprës, do të përcaktohej saktë a janë arritur këto objektiva apo jo. Shkalla e përfitimit apo siç theksohet kthimi i investimit në këtë rast do të përcaktohej saktë.

Përcaktime jo të sakta të qëllimeve dhe objektivave kemi në rastin e realizimit të projektit “Ndërtim By-Pass Durrës”. Segmenti rrugor i cili ishte parashikuar të ndërtohej me 4 korsi dhe me dy rrugë shërbimi përgjatë tij. Gjatë ndërtimit janë bërë ndryshime duke eliminuar rrugët e shërbimit për shkak të kostos së

lartë nga shpronësimet, si edhe faktin se ndërtimi i një rruge tjetër në proces fizibiliteti, merr një pjesë të trafikut të parashikuar në këtë rrugë.

Përcaktimi i përgjithshëm dhe i pa matshëm i objektivave bëhet shkak për mos vlerësimin e tyre siç duhet. Në këndvështrimin e auditimit, vlerësimi i realizimit të objektivave apo performanca e projektit, do të kishin rezultat më të madh në rastin kur ato janë përcaktuar saktë.

Nëse flasim për realizim objektivash në projektet e furnizimit me ujë, një shembull konkret i realizimit të mangët të objektivave është në rastin e projektit të furnizimit me ujë të qytetit Shkodër. Një ndër qëllimet e këtij projekti ishte instalimi i matësve të ujit, vendosja e të cilëve do të ulte sasinë e ujit të shpenzuar si dhe do të rriste sasinë e ujit të faturuar. Objektivi i mësipërm nuk është realizuar konkretisht si pasojë e mos vendosjes së numrit të parashikuar të sahareve matës.

Objektivi kryesor në kuadër të realizimit të projektit të furnizimit me ujë në Qytetin e Orikut është përmirësimin i furnizimit me ujë për banorët e qytetit Orikum si dhe i fshatrave përreth. Objektivi tjetër i këtij projekti është synimi i sigurimit të ujit të pijshëm pa ndërprerje për banorët. Nëse objektivi kryesor është i përgjithshëm dhe i pamatshëm, objektivi tjetër nuk është përcaktuar qartë, sepse sipas projektit duhet të përcaktohej objektivi “furnizim me ujë pa ndërprerje” dhe jo “synimi për furnizim me ujë pa ndërprerje”. Rezultati në fund të këtij projekti, furnizimi me ujë pa ndërprerje ose jo, nuk do të përbënte mos realizim objektivash.

Karakter tjetër i objektivave është koha. Pothuajse asnjë projekt i cili realizohet në vendin tonë nuk përfundon në kohën e caktuar. Si rezultat kemi

mungesë të përfitimeve në kohën e duhur, pagesa shtesë për shërbimet konsulente, ndikimet e çmimeve etj. Ndonëse objektivat që kanë të bëjnë me kohën në përgjithësi përcaktohen qartë, kjo vjen për shkak të lidhjes që ka faktori kohë më afatet e disbursimit të kredive.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, referuar auditimeve të realizuara kryesisht 3 vitet e fundit, ka rekomanduar duke vënë theksin në përmirësimin e procesit të hartimit të projekteve dhe përcaktimin e qëllimeve dhe objektivave të qarta. Gjithashtu, është kërkuar nga institucionet përkatëse të rrisin monitorimin gjatë procesit të hartimit të projekteve duke harmonizuar aktivitetet mes tyre, me synim hartimin dhe realizimin e projekteve në cilësinë e duhur, uljen e kostove dhe rritjen e përfitimeve.

KLSH ka rekomanduar që institucionet të rrisin përpjekjet për realizimin e detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjet financiare, sidomos sa i takon realizimit të procesit të shpronësimeve për interes publik. Mangësitë në realizimin e këtij procesi kanë shkaktuar vonesa të shumta në implementimin e projekteve, rrjedhimisht edhe rritje të kostos së tyre.

Rëndësia e auditimit në këtë fushë rritet edhe më tepër, sidomos pas miratimit të ligjit të ri të KLSH, i cili e zgjeron fushën, duke përfshirë edhe auditimin e fondeve të BE.